



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1480/6 Prot.

Vlorë më, 21.05. 2026

VENDIM

Nr. 33, datë 21.05.2026

"PËR KONSTITUIMIN E ANËTARIT TË RI TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT 'ISMAIL QEMALI', VLORË, PËRFAQËSUES I UV-SË

Në mbështetje të nenit 48 dhe 49 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 23, pika 4, dhe nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 14 të Rregullores së Brendshme të UV-së; nenit 5 të Rregullores së Funkcionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Vendimit të Senatit Akademik nr. 27, datë 13.05.2026, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 21.05.2026,

VENDOSI :

1. Të konstitujë në përbërje të Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, znj. Ledina Mançka, në cilësinë e anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues I UV-së.
2. Mandati i anëtarit të zgjedhur është mandat plotësues.
3. Ngarkohen Drejtorja e Shërbimeve Ndihmësakadematike dhe Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët

Alma Bakiu

Enida Pulaj

Enrik Mehmeti

Elmira Kushta

Ledina Mançka

Orkida Hasani

K R Y E T A R
Saniela Xhaferi

